



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.732/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit F. K. nga P., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë të kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 174 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të dënuarit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren PED.nr.1/2024 të datës 11.09.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1582/2024 të datës 02.10.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet si e papranueshme kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, e të dënuarit F. K., ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren PED.nr.1/2024 të datës 11.09.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.1582/2024 të datës 02.10.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin PKR.nr.54/2021 e datës 03.04.2023, të dënuarin F. K., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vrasje në tentativë të kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore nga neni 174 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite e 8 (tetë) muaj, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 04.03.2021 deri më datën 14.06.2021 dhe në arrest shtëpiak prej datës 01.06.2021 deri më datën 04.07.2021.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.390/23 të datës 19.09.2023 e ka refuzuar sitë pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit F. K., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Themelore në Prizren me aktvendimin PED.nr.1/2024 të datës 11.09.2024, e ka refuzuar kërkesën e të dënuarit F. K. për shtyrjen e mbajtjes së dënimit me burgim si të pabazuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktvendimin P.nr.1582/2024 të datës 02.10.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit F. K. për shtyrjen e ekzekutimit të vuajtjes së dënimit me burg dhe e ka vërtetuara aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar i dënuari F. K., me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoi kërkesën si të bazuar dhe të dënuarit ti bëhet shtyrja e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.416/2024 e datës 27.11.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit të hudhet si e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 435 par.1 dhe par.2 të KPPK-së, i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Kërkesa është e papranueshme.

Gjykata Supreme konstaton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur kundër aktvendimeve të lartpërmendura është e papranueshme për faktin se, sipas dispozitës së nenit 432 par.1 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë. Ndërkaq, sipas dispozitës së nenit 432 par.4 të KPPK-së, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

Në rastin konkret, nuk është fjala për procedurën penale por për procedurën *e ekzekutimit të sanksionit penal*, andaj për një vendim i cili nuk është marrë në procedurë penale dhe për këtë arsye nuk është përmbushur kushti i lartë cekur për lejueshmërinë e paraqitjes së këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Për arsyen e cekur më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u hodh si e palejueshme në kuptim të nenit 435 par.2 të KPPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.732/2024, më datë 05.12.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi